

Platforma për të Drejtat e Njeriut

Constitutional Articles: Liria e Besimit, e Ndërgjegjes dhe e Fesë

Constitutional Paragraph: 38 para 3

Askush nuk mund të detyrohet ose të ndalohet, në kundërshtim me ndërgjegjen e vet, që të marrë pjesë në praktikimin e fesë si dhe të bëjë publike bindjet ose besimin e tij/saj

Instrumentet ndërkombëtare Nenet

No results

Ligjet	Nenet
	Neni 99

Kodi nr. 06/1-006 i drejtësisë për të mitur

Aftësimi profesional dhe punësimi

Kodi nr. 06/1-006 i drejtësisë për të mitur

1. Gjatë kohës së mbajtjes së dënimit, të miturve u ofrohet aftësim i duhur profesional i bazuar në njohuritë e tyre, shkathtësitë, interesimet dhe punën që është duke e kryer, varësisht prej mundësive të institucionit korrektues. Bazat e trajtimit përfshijnë punën e dobishme edukative me shpërbllim përkatës, lehtësimin dhe inkurajimin e kontakteve me jashtë të të miturve përmes letrave, telefonit, pranimin e vizitave, vizitave në shtëpi, aktiviteteve sportive dhe ofrimit të kushteve të nevojshme për kryerjen e ritualeve fetare.

Neni 105

Kodi nr. 06/1-006 i drejtësisë për të mitur

Të drejtat e të miturit të garantuara gjatë ekzekutimit të masas edukative institucionale dhe burgimit për të mitur

Kodi nr. 06/1-006 i drejtësisë për të mitur

1. I mituri ndaj të cilit ekzekutohet masa edukative institucionale dhe burgimit për të mitur ka të drejtë por duke mos u kufizuar në:

1.21. ushtrimin e fesë;

decisionTitle*

decisionDescription*

Rasti u inicua një kërkesë (nr. 21924/05) kundër Republikës së Turqisë të paraqitur në Gjykatë, në bazë të nenit 34 të Konventës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore ("Konventa") nga një shtetas turk, z. Sinan I?k ("kërkuesi"), më 3 qershor 2005.

Rasti Sinan I?k k.
Turqise (21924/05)
02/02/2010

Aplikanti pretendoi, veçanërisht, se mohimi i kërkesës së tij për ta zëvendësuar fjalën "Islam" në kartën e identitetit të tij me emrin e besimit të tij "Alevi" shkelte nenin 9 të Konventës. Ai gjithashtu pretendoi një shkelje të neneve 6 dhe 14 të Konventës.

Gjykata vendosi se ka pasur një shkelje të nenit 9 të Konventës.